

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR 655 REP  
NR 94/2 KOL



**MARRËVESHJE PËR SHITJE KUOTASH**

Kjo marrëveshje nënshkruhet sot më datë 17.05 2019, në Tiranë, përpara meje Ilva Daci, Notere Publike në Tiranë, anëtare e Dhomës Noteriale Tiranë, me adresë në: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, 5/4, Tiranë, Shqipëri, midis palëve si vijon:

**NGA DHE NDËRMJET:**

Z. Muharrem Domi, lindur në Shijak, Shqipëri, më 24.07.1979, mbajtës i letërnjoftimit nr. 032866769 dhe me numër personal H90724133B, (më poshtë referuar si “**Shitësi**”).

**DHE**

Z. Vasil Ndreçka, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 18.07.1984, mbajtës i letërnjoftimit nr. 033527445 dhe me numër personal I40718073M, (më poshtë referuar si “**Blerësi**”).

Secili Shitësi dhe Blerësi, do të referohen më tej individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”.

**MEQENËSE:**

- A. Shitësi është ortak tek shoqëria PLAN OVER Shpk, një shoqëri e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi të biznesit (NUIS) L81520004H (“PLAN OVER”), me kapital në total në shumën 100.000 ALL.
- B. Shitësi, duke qenë zotërues dhe përfitues ligjor i 60% të totalit të kapitalit tek shoqëria PLAN OVER dëshiron të shesë 20% (njëzet përqind) të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë PLAN OVER (“Kuota e Shitjes”), në mënyrën e parashikuar në këtë Marrëveshje dhe Blerësi dëshiron të blejë dhe zotërojë Kuotën e Shitjes nga Shitësi, të lirë nga çfarëdolloj barre siguruese dhe bashkë me të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e ndryshëm, në kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë Marrëveshje.
- C. Palët dëshirojnë të lidhin këtë Marrëveshje për të përcaktuar kushtet dhe afatet e rëna dakord ndërmjet tyre për shitblerjen e Kuotës së Shitjes nga Shitësi tek Blerësi dhe të të drejtave dhe detyrimeve të Palëve.

**SA MË SIPËR, PALËT BIEN DAKORD MBI SA MË POSHTË VIJON:**

**1. SHITBLERJA E KUOTËS SË SHITJES**

Blerësi bie dakord të blejë dhe Shitësi bie dakord të shesë Blerësit, Kuotën e Shitjes të lirë dhe pa asnjë lloj barre, së bashku me të gjitha të drejtat, titujt, interesat dhe përfitimet që i përkasin kësaj kuote kundrejt vlerës së shitjes prej EURO 10,000 ("Vlera e Blerjes"), në Datën e Mbylljes.

## 2. PËRMBUSHJA

2.1. Përmbushja do të ndodhë në atë kohë dhe vend sikurse Palët kanë rënë dakord.

### 2.2. Në Datën e Përmbushjes:

- (i) Secila nga Palët do të nënshkruajë dhe dorëzojë këtë Marrëveshje;
- (ii) Blerësi do të paguajë Vlerën e Blerjes Shitësit nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë e Shitësit pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje;
- (iii) Pavarësisht, paragrafit (ii) të këtij neni, Shitësi i transferon Blerësit të drejtën e pronësisë mbi Kuotën e Shitjes dhe do të kryejë të gjitha aktet dhe veprimet e nevojshme sikurse mund të kërkohet lidhur me transferimin e titullit të pronësisë mbi Kuotën e Shitjes në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

### 2.3. Veprimet për Përmbushjen:

2.3.1. Shitësi ka zhvilluar Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të PLAN OVER, në të cilën është miratuar transferimi i Kuotës së Shitjes dhe Blerësi do të regjistrohet si zotëruesi dhe përfituesi ligjor i Kuotës së Shitjes.

2.3.2. Shitësi do të bëjë të mundur që PLAN OVER të kryejë aplikimet dhe raportimet sipas kërkesave ligjore në lidhje me Përmbylljen, përfshirë paraqitjen dhe depozitimin e të gjithë dokumenteve dhe shkresave pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2.3.3. Shitësi këtu deklaron nën vullnetin e tij të lirë se Kuota e Shitjes do t'i transferohet Blerësit në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; dhe Shitësi, ose ndonjë palë e tretë nuk do të kenë asnjë pretendim, të drejtë, titull ose interes në të.

2.3.4. Më tej, në datën e kësaj Marrëveshjeje, Shitësi konfirmon se ai nuk ka ndërmarrë asnjë veprim i cili mund të ndikojë negativisht në të drejtën, titullin ose interesat e Blerësit në Kuotën e Shitjes.

## 3. Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit:

Shitësi deklaron, garanton dhe merr përsipër ndaj Blerësit se:

- a) ai ka siguruar të gjitha miratimet e nevojshme për t'i mundur atij lidhjen dhe zbatimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe mungesa e këtyre



miratimeve do të ndikonte negativisht në aftësinë e tij për të lidhur dhe përmbushur detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje;

- b) Me nënshkrimin e saj kjo Marrëveshje përmban detyrime të vlefshme dhe të zbatueshme për të;
- c) nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të rezultojë në shkelje të ndonjë ligji ose të ndonjë urdhri, dekreti ose vendimi të ndonjë gjykate ose ndonjë autoriteti shtetëror, kur ndonjë shkelje e tillë do të ndikonte materialisht në aftësinë e tij për të lidhur ose zbatuar detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### 4. **Deklarime dhe Garanci të Blerësit**

Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a) ai ka marrë të gjitha miratimet e nevojshme për të nënshkruar dhe zbatuar detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe mungesa e këtyre miratimeve do të ndikonte negativisht në aftësinë e tij për të lidhur dhe përmbushur detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshje;
- b) Me nënshkrimin e saj kjo Marrëveshje përmban detyrime të vlefshme dhe të zbatueshme për të; dhe
- c) nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të rezultojë në shkelje të ndonjë ligji ose të ndonjë urdhri, dekreti ose vendimi të ndonjë gjykate ose ndonjë autoriteti shtetëror, ku cilado shkelje e tillë do të ndikonte materialisht në aftësinë e tij për të nënshkruar këtë marrëveshje ose zbatuar detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### 5. **DËMSHPËRBLIM**

Palët bien dakord ndërmjet tyre se në rast të ndonjë dëmi ose humbje që mund të lindë nga ose lidhet me ndonjë pasaktësi, keqinterpretim ose shkelje të secilës prej deklarimeve ose garancive të dhëna nga Palët sipas Nenit 3 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje, Pala që kryen shkeljen (“**Debitori**”) do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Palën tjetër (“**Përfituesi**”) për humbjen ose dëmin.

#### 6. **LIGJI I ZBATUESHËM, JURIDIKSIONI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 6.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe lidhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm në Shqipëri.
- 6.2 Një Palë e cila ngre një konflikt, mosmarrëveshje, ose paqartësi që rrjedh nga ose lidhet me këtë Marrëveshje, ose lidhjen, interpretimin, vlefshmërinë, zbatimin, shkeljen ose përfundimin e saj, përfshirë, parashikimet e këtij neni 6 (së bashku “**Mosmarrëveshjet**”), përmes një njoftimi me shkrim (një “**Njoftim mbi Mosmarrëveshjen**”) do të informojë Palët e tjera për Mosmarrëveshjen. Pas marrjes së këtij Njoftimi mbi Mosmarrëveshjen, Palët do të bëjnë përpjekjet më të mira për të zgjidhur Mosmarrëveshjen përmes diskutimeve

miqësore.

6.3 Çdo mosmarrëveshje e cila nuk është zgjidhur sipas interesit të Palëve, në përputhje me kushtet e Nenit 6.2, brenda 20 (njëzet) Ditëve të Punës nga data e Njoftimit të Mosmarrëveshjes, do të referohet dhe zgjidhet përfundimisht ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me parashikimet e Ligjit Shqiptar.

6.4 Kostot e gjykatës do të paguhet nga Palët e Mosmarrëveshjes sikurse do të vendoset nga gjykata.

## 7. EFEKTSHMËRIA DHE PËRFUNDIMI

7.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e Përmbushjes, sipas nenit 2.2 të kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Zgjidhja, ose përfundimi e kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojë ndonjë Pretendim ose të drejtë që ka i ka lindur Palëve përpara përfundimit. Pavarësisht përfundimit, Neni 6 (Ligji i Zbatueshëm, Juridiksioni dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve), 7 (Efektshmëria dhe Përfundimi), 8 (Njoftimet) dhe 9 (Të Ndryshme) do t'i mbijetojnë zgjidhjes ose përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

## 8. NJOFTIMET

8.1 Çdo njoftim që parashikohet në këtë Marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe do të realizohet fillimisht përmes emailit dhe më pas e konfirmuar përmes dërgimit me postë rekomande nëpërmjet shërbimeve postare shqiptare të njohur, në mënyrën sikurse zgjidhet nga Pala që bën njoftimin.

8.2 Të gjitha njoftimet do të vlerësohen se janë dërguar rregullisht në: (i) Ditën e Punës që pason datën e transmetimit me konfirmim marrje, nëse dërgohet me email; (ii) ditën e marrjes (nëse është Ditë Pune dhe në rast se kjo ditë nuk është Ditë Pune atëherë në ditën vijuese të menjëhershme të punës), nëse dërgohet me korrier; ose (iii) kalimin e 7 (shtatë) ditëve nga dërgimi me postë, nëse dërgohet me postë rekomande.

8.3 Çdo Palë, kohë pas kohe mund të ndryshojë adresën ose përfaqësuesin e tij për marrjen e njoftimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje duke i dërguar të gjitha palëve të tjera paraprakisht njoftim me shkrim, jo më pak se 10 (dhjetë) ditë.

## 9. TË NDRYSHME

### 9.1. Rezervimi i të Drejtave

Asnjë vetëpërmbytje, privilegj ose lehtësim ose mosveprim nga ndonjë Palë në çdo moment kur bëhet i kërkueshëm zbatimi i ndonjë parashikimi të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të ndikojë, zvogëlojë, ose paragjykojë në ndonjë mënyrë, të drejtat e kësaj Pale për të kërkuar



zbatimin e këtij parashikimi dhe çdo dorëheqje, ose pranim i heshtur nga cilado Palë e ndonjë shkelje të ndonjë prej parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të vlerësohet si dorëheqje nga, ose pranim i heshtur i ndonjë shkelje në vazhdim, ose pasuese e këtyre parashikimeve, heqje dorë nga ndonjë e drejtë që rrjedh nga kjo Marrëveshje, ose pranim i heshtur i, ose njohje e të drejtave të tjera, përveç atyre të parashikuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.

#### 9.2. Të drejta Kumulative

Të gjitha dëshmipërblimet e cilësdo Palë sipas kësaj Marrëveshjeje, të parashikuara këtu në këtë Marrëveshje, ose të njohura nga ligji, janë kumulative dhe jo alternative dhe mund të zbatohen njëkohësisht, ose jo.

#### 9.3. Pavlefshmëria Pjesore

Nëse ndonjë parashikim i kësaj Marrëveshjeje ose zbatimi i saj tek ndonjë person ose rrethanë do të jetë e pavlefshme ose të pazbatueshme deri në ndonjë masë, pjesa e mbetur e kësaj Marrëveshjeje dhe zbatimi i këtyre parashikimeve tek persona ose rrethana të ndryshme nga ato për të cilët ajo vlerësohet si e pavlefshme ose e pazbatueshme nuk do të ndikohen dhe çdo parashikim i kësaj Marrëveshjeje do të jetë i vlefshëm dhe i zbatueshëm deri në masën që lejohet nga ligji. Çdo parashikim i pavlefshëm ose i pazbatueshëm i kësaj Marrëveshjeje do të zëvendësohet me një parashikim, i cili është i vlefshëm dhe i zbatueshëm; që reflekton maksimalisht synimin fillestar të parashikimit të pazbatueshëm dhe sikurse është rënë dakord nga Palët.

#### 9.4. Ndryshime

Asnjë ndryshim ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë dorëheqje nga ndonjë prej kushteve ose afateve të saj nuk do të jetë i vlefshëm ose i zbatueshëm, përveç se kur bëhet me shkrim dhe nënshkruhet rregullisht nga të dyja Palët.

#### 9.5. Mos Transferimi

Asnjëra nga Palët nuk do të cedojë ose kalojë këtë Marrëveshje ose ndonjë nga të drejtat ose detyrimet rrjedhojë e saj tek ndonjë palë e tretë, pa miratimin paraprak të shprehur me shkrim të Palës tjetër. Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme dhe në përfitim të Palëve. Çdo cedim ose kalim i kësaj Marrëveshjeje në shkelje të parashikimeve të këtij Neni 9.5 do të jetë absolutisht i pavlefshëm, *ab initio*.

#### 9.6. Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje përbën të gjithë marrëveshjen e lidhur ndërmjet Palëve lidhur me objektin e saj dhe zëvendëson çdo dhe të gjitha marrëveshjet e mëparshme, përfshirë memorandum mirëkuptimit dhe letra interesin, qoftë verbale ose me shkrim, ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje.

#### 9.7. Marrëdhënia

Asnjë nga parashikimet e kësaj Marrëveshjeje nuk do të vlerësohet se përbën një partneritet ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë Palë nuk do të ketë autoritet për të detyruar Palën tjetër përveç sa parashikohet në këtë Marrëveshje, ose të vlerësohet se është agjenti i Palës tjetër në ndonjë mënyrë.

9.8. Kostot

Blerësi dhe Shitësi do të jenë njësoj përgjegjës për çdo kosto që ka pësuar Pala tjetër në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.9. Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në 3 (tre) kopje, secila do të vlerësohet jete origjinale, por të gjitha do të përbëjnë një dhe të vetmin instrument.

9.10. Ndryshimi i Ligjit

Në rast të ndonjë ndryshimi në ligj i cili ndikon në kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të rishikohet dhe nëse Palët e vlerësojnë të nevojshme do të ndryshohet dhe/ose ri negociohet në mirëbesim, në mënyrë që të reflektojë bazat e bashkëpunimit tregtar ndërmjet Palëve.

9.11. Gjuha

E gjithë korrespondenca, njoftimet, raportet dhe çdo komunikim tjetër ndërmjet Palëve do të jetë në Shqip, e cila do të jetë gjuha e kësaj Marrëveshjeje. Çdo Mosmarrëveshje që do të lindë si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje, do të ndiqet dhe gjykohet në Shqip.

**NË PRANI TË PALËVE MË POSHTË, PALËT NË VIJIM BËJNË QË KJO MARRËVESHJE TË LIDHET NË DATËN E PËRMBUSHJES.**

**SHITËSI**

**Z. Muharrem Domi**

*Muharrem Domi*

**BLERËSI**

**Z. Vasil Ndreçka**

*Vasil Ndreçka*

**NOTERI**

**ILVA H. DACI**

*Ilva Daci*

*Daci*



---

**REZULTATET E KËRKIMIT**

---

Numri i Rezultatit të Kerkimit:	D-20190517101456729
Data e Rezultatit të Kerkimit:	17.05.2019
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	10:14:56AM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-650-102
Referenca e Përdoruesit:	

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0**

PLAN OVER SH.P.K.

